

os e kërkonti dem...  
maja, jetojeni aty ku dora dhe ma...  
famalen, për ata që janë nd...  
Këto janë vende në të cilat në një periudhe ko...  
ër dekada të tëra, qeveris një elitë e caktuar...  
Një pyetje më mundon: a është kjo "shoqëri demokratike" një reflek...  
tim i klasës tonë politike? Apo mos është vetë "shoqëria demokratike" ajo që...  
e ka projektuar këtë klasë politike?  
shpesh shqiptarët fajësojnë shtetin për të ardhurat e tyre, a thua se është detyra e shtetit që ata...  
të marrin të ardhura pa bërë asnjë përpjekje, dhe harrojnë se shteti janë ata vetë. Shteti nuk...  
ka detyrë asnjë... ku thuhet se ligjet duhet të shkelen, se shqiptari nuk duhet të doj...  
shqiptarin e se për... të paguainjë paradhënie.

# Demokracia dhe të rinjtë Ç'është demokracia për mua?

Përmbledhje esesh



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca në Shqipëri

e ka... litike?  
shpesh shqiptarët fajësojnë shtetin për të ardhurat e tyre, a thua se është detyra e shtetit që ata...  
të marrin të ardhura pa bërë asnjë përpjekje, dhe harrojnë se shteti janë ata vetë. Shteti nuk...  
ka detyrë asnjë... ku thuhet se ligjet duhet të shkelen, se shqiptari nuk duhet të doj...  
shqiptarin e se për... të paguainjë paradhënie.

# Demokracia dhe të rinjtë Ç'është demokracia për mua?

*Përmbledhje esesh*

### *Shënim*

Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë botim janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën apo qëndrimin zyrtar të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

### **Të dashur lexues,**

Demokracia është zëri i njerëzve në veprim; ajo është zëri i atyre që kanë diçka për të thënë. Demokracia s'është thjesht një traditë apo dhuratë e trashëguar, e cila nxirret para të tjerëve që ta admirojnë si të ishte një plaçkë e vyer. Demokracia është veprim, ndaj ajo duhet praktikuar. Demokracia është diçka që duhet vënë në jetë. Dhe, si shprehja e çdo veprimi të sofistikuar, ajo duhet mësuar që kur jemi të rinj, në mënyrë që të mos harrohet më kurrë.

Esetë e këtij publikimi janë hapi i parë i vënies në lëvizje të muskujve që do të forcohen më tej. Ato janë pjesë e eseve pjesëmarrëse në konkursin me titull “Rinia dhe Demokracia”, organizuar në kuadrin e një projekti për forcimin e pjesëmarrjes qytetare – veçanërisht të të rinjve – në procesin e vendimmarrjes në nivel vendor dhe qendror. Kjo ishte një përpjekje për të nxitur mendimin kritik në lidhje me rolin e të rinjve në demokraci, për ta eksploruar këtë çështje dhe për të gjetur zërin e tyre. Kësisoj, të rinj 16 dhe 18 vjeçarë nga i gjithë vendi u ftuan të thonë: “Ç’kuptim ka demokracia për mua?”

Përgjigjet që morëmishin të goditura: të shumëllojshme, të fuqishme, inteligjente, të artikuluar, shpeshherë mjaft personale. Të rinjtë, të çliruar nga çdo ndikim apo interes vetjak, të interesuar të nxisin procesin e ndryshimit të shoqërisë, e ngritën zërin e tyre në mënyrë që ai të dëgjohet dhe nuk u druajtën të luajnë një rol më aktiv. Ata e kuptuan pjesëmarrjen si marrjen e pjesës që u takon, si në marrjen e vendimeve për ndërtimin e së ardhmes, ashtu dhe në marrjen e përgjegjësisë për rezultatin. Këto ese shprehin kuptimin e demokracisë; botimi i tyre në vetvete tregon thelbin e saj. Zëri i këtij brezi – brezi i parë i lindur pas rënies së komunizmit, brezi i parë që arriti moshën e pjekurisë në shekullin 21, brezi i parë që mund t'i sjellë diçka të re tek tranzicionet e shumta që ka kaluar ky vend – do të forcohet gjithmonë e më tej.

Shpresoj të gjeni kënaqësi duke i lexuar këto ese – si dhe duke dëgjuar dhe reaguar.

### **Robert Wilton**

*Kryetar në Detyrë*

*Prezenca e OSBE-së në Shqipëri*

**Nga:**

Ledion Onuzi  
Bojana Spahija  
Edisnajda Shaholli  
Adela Vagollari  
Laura Gjopalaj  
Gentiana Caco  
Orgeta Fiku  
Xheniola Gjoni  
Neada Kallanxhi  
Artjola Avdia  
Enida Bici  
Griselda Meti

Termi 'demokraci' tek ne mbase mund të barazohet më mirë me termin post-diktaturë. Demokracia shqiptare i ngjan një adoleshenti që hera herës është i vrullshëm, i paparashikueshëm, kokëfortë, hatërmbetës, egoist, pa përvojë, por me dëshirën e madhe për të qenë dikushi. Dhe, sikurse ndodh ngaherë, vjen një ditë që edhe adoleshenti më klasik, befas e ndjen veten të rritur. Kjo ditë është duke ardhur edhe për demokracinë shqiptare.

**Fatos Baxhaku, publicist**  
gusht 2013

Sistemi demokratik ka triumfuar në botë pasi ka krijuar tek masa e popullatës besimin se ofron më shumë drejtësi se sistemet e tjera politike. Gjate këtyre viteve klasa politike shqiptare ka dështuar në mënyrë spektakolare në ofrimin e drejtësisë dhe si pasojë ka krijuar deformime të thella në strukturën sociale të vendit. Këto deformime janë konsoliduar dhe e bëjnë më të vështirë përpjekjen për ta çuar vendin drejt një demokracie funksionale.

**Gjergj Bojaxhi, figurë publike**  
gusht 2013

Demokracia, sistemi i fituar pas rënies së komunizmit, solli, përveç disa të drejtave që fituam, edhe lirinë më të rëndësishme; lirinë për ta shprehur mendimin lirshëm. Por pikërisht liria e fjalës është keqkuptuar nga shumë njerëz, të cilët s'bëjnë gjë tjetër veçse vjellin vrer në emër të saj. Në Shqipëri demokracia vazhdon të mbetet një bonsai, një pemë e brishtë në vazo, e cila ka nevojë për pleh të posaçëm për të jetuar shëndetshëm, një pemë e cila do ujin me masë, si dhe shumë dritë që të mos vyshket. Kujdestarët e demokracisë tonë e njohin rishtas "pemën në vazo", dhe këtë e kanë kuptuar të rinjtë, ata që kanë nisur ta zbërthejnë kuptimin e saj, dhe që, në një të ardhme, duke ia njohur mangësitë, mund t'i kthejnë në mësim të vlefshme për një sistem më të mirë qeverisjeje.

**Rezarta Delisula, gazetare**  
gusht 2013

**Ledion Onuzi**  
*Kukës*

## Ç'është demokracia për mua?

Teksa shihja lajmet në televizion, më bëri përshtypje një protestë e dhunshme e organizuar në Athinë kundër krizës që kishte pllakosur Greqinë. Pyeta veten: pse duhen goditur policët, pse duhet të thyhen dyqanet, pse duhet t'u vihet flaka makinave? Pse duhet të ndodhë kjo në vendlindjen e shtetit të parë demokratik në botë, në vendin që shpiku demokracinë? Si ishte e mundur që dy mijë vjet më parë, pesë mijë athinas votonin dhe vendosin për fatet e Athinës, ndërsa në ditët e sotme, tjegullat që kishin përdorur në vend të votës po i përdornin si mjete kundër policisë dhe shtetit?

Çfarë ka ndryshuar – pyeta veten – mes këtyre dy kohëve?! Ndoshta vendi?!- Jo. Është po ajo, Athina. Njerëzit?! Jo, janë athinasit e rinj, gjaku dhe ADN-ja e athinasve që ngritën tempullin e demokracisë. Çfarë ka ndryshuar atëherë?! Ah po; mbase demokracia kërkonte vendet e hapura, ku zgjedhësi dhe i zgjedhuri, ku qeveritari dhe rrogëtari të ishin shumë afër njëri-tjetrit, të takoheshin dhe të përshëndeteshin me respekt e mirënjohje, e ku të zgjedhurit të jepnin llogari çdo ditë. Siç duket, dallimi mes popullit në rrugë dhe qeveritareve në zyra qenka bërë i madh. Mesa duket këta të fundit nuk i paskan pyetur qytetarët për gjërat më të rëndësishme, dhe kjo mos-pyetje ka rënë si një barrë e rëndë mbi të gjithë.

E mirë thashë, fundi fundit; jo se nuk më vjen keq për Greqinë, por unë kam vendin tim, Shqipërinë time. Ka vuajtur e shkreta Shqipëri për një gjysmë shekulli, atëherë kur fjala demokraci nuk përmendej, ose sikurse më thonë prindërit, kishte edhe parulla të tilla që demokracinë e barazonin me diktaturën. Shpatet e maleve shqiptare mbanin parulla që shkruanin “Diktatura e proletariatit është demokracia e vërtetë”. Ç'ti bësh, sot të vjen të qeshësh, por prindërit tanë e dinë se sa vuajtën për të drejtën e shkollës, për të drejtën e fjalës, apo për frikën se nëse flet apo kundërshton, futesh në burg politik. Edhe unë kam axhë Esatin, i cili vuajti 18 vjet burg politik gjatë diktaturës, vetëm pse kishte shprehur pakënaqësi për disa direktiva të partisë. Ai vdiq një vit më parë, me brengën se nuk arriti të kompensojë vitet e burgut. Ai vdiq dhe la pas një familje shumë të varfër.

Unë dhe shokët e mi lindëm kur demokracia kishte pak vjet jetë. Natyrisht nuk mund ta perceptojmë siç duhet atë që u ka ndodhur prindërve tanë. U lindëm të

lirë, kemi shumë të drejta. E drejta për jetën, e drejta për t'u arsimuar, për t'u shprehur, është e dukshme dhe e prekshme nga të gjithë. E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur shihet çdo ditë, pasi fushata zgjedhore çuditërisht, ndoshta pa të drejtë, përfshin edhe moshën tonë. Shoh mitingjet e partive të shumta politike, fotot e retushuara të kandidatëve për deputetë që mbulojnë faqet e mureve me suva të prishura. Shikoj Kukësin të mbushur me njerëz, shoh lëvizje makinash të mbuluara me foto, shoh tabela partish të mbushura me numra.

A nuk është kjo demokracia? Ja, edhe kryetari ynë ka kaluar me një parti tjetër! Dëgjoj premtime, më shumë se herët e tjera, shikoj më shumë buzëqeshje, por gjithashtu shoh frikë. Te njëjtët njerëz i dëgjoj teksa u japin fjalën kandidatëve të ndryshën se do t'u japin votën. Dëgjoj tek-tuk, ndonjë thashethem se ndonjë kandidat ofron para për votat që merr. Mos qoftë e vërtetë; ç'do mbetej pastaj nga demokracia që ngriti në këmbë kombet më me emër?!

Pranë shtëpisë time tek lagjja 6 kam Drejtorinë e Policisë. Të burgosurit dergjen në bodrumin e kësaj ngrehine. Ka plot syresh, por mesa di unë, asnjë nuk është dënuar se ka folur kundër qeverisë. Nuk dëgjoj të bërtitura nga rrahjet e tyre, pasi ata nuk mund të preken, më thotë im atë, sepse ndryshe polici hiqet nga puna. Ou, thashë me vete, edhe hajduti dhe krimineli paskan të drejta në demokraci!

Pak më tutje ndodhet gjykata e rrethit. Njerëzit e qytetit tim kurrë nuk e quajnë "Pallati i Drejtësisë" por thonë se është ndërtesa e ish-komitetit të Partisë. Prindërit më kanë treguar se para viteve '90 këtu ishin zyrat e drejtuesve të Partisë së Punës, vendi nga kishin dalë urdhrat e arrestimeve dhe dënimeve me vdekje. Nuk dua të besoj atë që thuhet, se ky pallat nuk mund të quhet kurrë pallat drejtësie, as nuk dua ta besoj se njerëzit humbasin vite kohë dhe shpenzojnë shumë para për të zgjidhur ankesat që bëjnë. Ndryshe, ku vajti drejtësia? Dhe pyes, vallë a ka lidhje drejtësia me demokracinë? A janë ato dy motra që s'mund të jetojnë pa njëra-tjetrën?

Televizioni më përcjell për në dhomën e gjumit, ndërkohë që nëpër lajmet e gazetave shajnë pa pushim qeverinë dhe kryeministrin. Njëherë nuk mu duk normale, sepse mendoja se në momentin kur fiton një qeveri, duhet te respektohet dhe të mos shahet.

Por më vonë e kuptova se njerëzve që mbajnë qeverinë dhe pushtetin duhet t'u tërhiqet veshi sa herë që shkelin të drejtat e njerëzve, sa herë nuk mbajnë

premtimet. A nuk është edhe kjo demokraci?

Qyteti im vitet e fundit është afruar me Tiranën, për shkak të rrugës së kombit. Çdo fundjavë më vjen në shtëpi im vëlla, student në Tiranë. Ai mërzhitet që Kukësi, vendlindja e vet mes ujërave, nuk ka ujë të pijshëm më shumë se 3 herë në ditë nga një orë. Im vëlla më thotë se tek ne nuk ka shoqëri civile, sepse ndryshe, njerëzit duhet të ngriheshin e të protestonin për mungesën e ujit të pijshëm.

Një ditë pyeta axhë Jonuzin: pse nuk organizohen njerëzit në protesta për ujin? Më tha se njerëzit kanë frikë mos i heqin nga puna. Më erdhi keq që edhe në demokraci njerëzit mund të kenë frikë të dalin për të protestuar.

Me date 28 qershor të këtij muaji do na vijë axhë Gëzimi nga Amerika. Ka 15 vite që jeton atje me familjen dhe ushtron profesionin e mësuesit. Gjithnjë më thotë: "Ledi, Amerika është toka e mundësive, por s'të bën të pasur pa punuar". Kështu duhet të bëhet edhe Shqipëria. Vetëm atëherë demokracia do të fitojë vlerën e vet universale.

Jam një nga ata mijëra të rinj që duan ta bëjnë Shqipërinë një vend të mundësive. Sa herë duhet përsëritur kjo? Pa patur mundësi për ndryshim, asgjë nuk ndryshon. Demokracia mund të ketë vlerë në vendin tim, vetëm atëherë kur ky vend të shndërrohet në një vend të mundësive.

Jam i sigurt se një ditë kjo do ndodhë dhe unë do ta arrij atë ditë.

Bojana Spahija  
Shkodër/Tiranë

## Ç'është demokracia për mua?

Unë jam Bojana. Kam lindur në Shkodër. Thonë se ky është një qytet me demokraci të zhvilluar tek qytetarët e tij. Prindërit më kanë thënë se ky qytet ka qenë i tillë në çdo kohë, jo vetëm kur në Shqipëri sundonte diktatura. Këtu njerëzit kanë guxuar shumë të dalin hapur kundër regjimit të dikurshëm dhe për këtë edhe janë ndëshkuar shumë. Ky qytet ka pasur numrin më të madh të të burgosurve dhe të të vrarëve, sidomos të klerikëve të besimeve të ndryshme, për hir të lirisë së mendimit dhe asaj të të shprehurit.

Ndërsa sot unë jam e lirë të them mendimin tim. Mund të them: “Ç’është demokracia për mua?” Jam e lirë të shprehem.

Si nxënëse e shkollës së mesme të gjuhëve të huaja “Asim Vokshi” jam mësuar që punën me hartimin e një teksti ta nis duke përcaktuar fjalët kyçe dhe ballafaqimin e tyre me fjalorin. Mendova, së pari, të hap fjalorin për të parë kuptimin e fjalës “demokraci” në fjalorin e shqipes.

DEMOKRACI,-A *f.sh.*,-TË. 1. Regjim a sistem politik, ku pushteti ushtrohet nga populli drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve të zgjedhura, ku shtetasit gëzojnë liri a të drejta të barabarta; shtet ose vend që ka këtë regjim a këtë organizim politik.

2. E drejta dhe mundësia që u jepet anëtarëve të një kolektivi a tërë popullit për të thënë fjalën lirisht për të gjitha çështjet politike, shoqërore etj. *Demokracia në shkollë (në familje.)*

Nga gjithë ky përkufizim më mbeti në mendje si e kuptueshme fjalia ilustruese: *Demokracia në shkollë (në familje.)* Pra, liri dhe të drejta të barabarta në shkollë dhe në familje. Kështu duhet ta kuptoj unë demokracinë sipas shpjegimit që më vjen nga fjalori, por edhe sipas moshës sime. Fjalët kyçe që shoqërojnë kryefjalën e esesë sime mbi demokracinë do të jenë: “liri”, “Shkodër”, “familje”, “shkollë” dhe “dije”.

Familja ime jeton në Shkodër. Nëna ime ka punuar gjatë si mësuese në një fshat me banorë të shpërngulur nga zonat e thella. Një ditë ajo erdhi e shqetësuar dhe më tha se Arlinda, nxënësja e saj më e mirë, të cilën e kisha parë në foto duke i dhuruar lule në 7 mars, ishte ngujuar së bashku me vëllezërit dhe prindërit e saj.

Familja e saj kishte rënë në gjak. Arlinda nuk do të shkonte më në shkollë. Unë dhe moshatarja ime nuk kishim më të njëjtat të drejta për të jetuar, as për t’u arsimuar njësoj.

Arlinda kishte humbur lirinë.

S’mund t’i harroja për një kohë të gjatë sytë e saj plot dritë në foto dhe mendoja se në to tashmë duhet të kishte shumë lot dhimbjeje dhe pamundësie. S’do të ishte më as mes shokësh dhe shoqesh. Askush s’do ta dëgjonte zërin e saj në liri. Do të jetonte pa pasione.

Në izolim total, gati çnjerëzor, për shkak të vendimit të prindërve për të kursyer fëmijët e tyre nga kontakti i parakohshëm me botën e atyre të rriturve, që mendojnë tmerrshëm se gjaku duhet të paguhet me gjak.

Si mund të ndodhte kjo në një vend demokratik? Aq pranë një qyteti-djep kulture si Shkodra? *“Shtetasit gëzojnë liri a të drejta të barabarta”*-thotë shpjegimi kuptimor i fjalorit. Mbase, por jo këtu.

Kur erdha një ditë në shtëpi dhe u thashë prindërve se nota e testit të radhës në anglisht nuk ishte dhjetë, ata u mërzitën shumë. “Sa më shumë të investosh në dije, aq më e lirë do të jesh.”-më tha nëna ime. Po Arlinda, iu përgjigja, e harrove? Si do të bëhet ajo e lirë nga dija? Nuk shkon dot në shkollë. Ajo s’mund të jetë më e lirë as nga padija. Edhe dritën e diellit duhet ta shohë vetëm nga dritarja. A mund të flasë kush për të drejtat e saj brenda familjes, apo në shoqëri?

A s’është njësoj si në burg edhe familja e saj. Në burgun që i ve kanuni apo çfarëdo emri tjetër të ketë, s’ka rëndësi. Familja e saj nuk vendos dot më se çfarë duhet të ndodhë? Pjesëtarëve të saj i kanë kufizuar edhe të drejtën e jetës. Ku po ndodh kjo? Sot. Në qytetin tim. Në demokraci. Shkodra ende ka numrin më të madh të të vrarëve nga ky fenomen i shëmtuar. Shkodra ka ende të burgosurit e saj.



Jo në burgjet e shtetit, si dikur në diktaturë, por brenda katër mureve. Një vajzë 17-vjeçare privohet nga çdo e drejtë që i sjell asaj demokracia.

Ç'formë e organizimit shtetëror do të mund ta shpëtonte jetën e Arlindës për të jetuar e lirë, që të marrë dije, të ketë të drejta, por edhe detyra në shkollë dhe në familje? Unë nuk di t'i jap përgjigje kësaj pyetjeje, por di të them se jo kjo formë shtetërore që kemi tani dhe që quhet demokraci.

Në qoftë kështu demokracia, atëherë qenka shumë e vërtetë shprehja që kam lexuar në një tekst historie se “Demokracia është forma më e keqe shtetërore...” Natyrisht, me përjashtim të të gjitha të tjerave.

Atyre për të cilat më kanë folur prindërit, për vitet e diktaturës. Për t'i kthyer sërish atë shkëlqim sysh moshatares sime apo të tjerëve si ajo, do të doja të bërtisja fort kundër kësaj “demokracie” të mbytur nga indiferenca: “Po jetës dhe lirisë!”

## Ç'është demokracia për mua?

Demokracia është një sistem i pranuar gjerësisht në kohën që jetojmë. Diskutimet janë të shumta për sa i përket demokracisë dhe sa reale është ajo në Shqipëri. Në një sondazh del që Shqipëria zë vendin e 80-të në botë për demokracinë e saj. Duhet të mburremi për këtë arritje apo duhet t'i futemi punës për një demokraci më të fortë?

Megjithatë historia ka treguar se vendet që kanë një demokraci të mirë kanë kaluar një kohë të gjatë historike nën këtë sistem. Teorikisht për demokracinë ekzistojnë disa përkufizime. Një prej tyre thotë se demokracia është qeverisja nga populli, ku pushteti më i lartë i takon atij.

Nga jashtë kjo gjë duket shumë e thjeshtë, por duke u ngritur çdo ditë në mëngjes dhe duke jetuar në një vend që ka një demokraci 23 vjeçare të le të kuptosh problemet dhe arritjet e një shteti nën këtë sistem.

Teorikisht demokracia është një ëndërr që barazohet me parajsën dhe që është plot vlera, por siç thotë edhe Dante: “Jo më pak se dija, dyshimi më pëlqen”.

Sepse dyshimet janë të shumta kur bëhet fjalë si funksion shteti, çfarë është demokracia dhe ç'rol luaj unë në të? Këtë vit u hodh ideja që të votonin edhe 16 vjeçarët, gjë që s'u bë realitet. Në vendin tonë votojnë personat mbi moshën 18 vjeçare.

Kështu nëpërmjet votës, ata zgjedhin personin e duhur për t'i përfaqësuar.

Votimin e bëjnë pa detyrim ose dhunë. Të gjithë njerëzit mbi këtë moshë shprehin mendimin nëpërmjet votës pa dallim feje, gjinie, ngjyre, gjuhe apo krahine. Kjo është një pjesë e demokracisë. E unë kisha shumë dëshirë të bëhesha pjesë e kësaj gjenerate më 23 qershor, pasi unë jam 16 vjeç, dhe si unë shumë të tjerë të moshës sime mendojmë se jemi të përgjegjshëm për të ardhmen tonë e të vendit tonë, prandaj duhet të votojmë!

Pra pjesëmarrja e njerëzve që votojnë për të ardhmen e tyre duhet të parashi-kohet nga ligjet e një vendi demokratik, të cilat duhet të ndryshojnë, në qoftë se u ka ikur koha.

Them kështu sepse ky brez që unë jam, ka aftësi dhe zotësi për të vendosur për fatet e veta. Nëse hapim televizorin, përditë dëgjojmë kontradikta nga më të ndryshmet midis politikanëve. Të pafundme janë akuzat që ata i bëjnë njëri-tjetrit për ndarjen e pushteteve, dhe për funksionimin e tyre. Në demokraci ekzistojnë tre pushtete dhe nga vetë fjala ndarje e pushteteve ato duhet të veprojnë të pavarura dhe të lira kundrejt njëri-tjetrit. Kushedi sa herë në ditë hasim fjalën korrupsion.

Pra të fitosh në kurriz të tjetrit. Kjo gjë nuk është e pranueshme dhe në një shtet demokratik kjo dënohet rëndë. Shteti është i zgjedhur nga populli dhe duhet të veprojë, duke marrë parasysh nevojat e çdo qytetari. Demokracia nuk garanton barazinë e kushteve, por barazinë e mundësive. Demokraci për mua do të thotë mungesë e krimit dhe e dhunës. Janë dy faktorë që dëmtojnë rëndë shoqërinë. Një shtet i organizuar duhet t'i kufizojë dhe t'i ketë nën kontroll këto ngjarje të padëshirueshme duke mos hapur më plagë në shoqëri.

Demokraci për mua do të thotë drejtësi, ku gjithçka gjykohet sipas ligjeve demokratike, ku çdo njeri merr meritën e vet. Të studiojë aty ku do, të jetojë në vendin që pëlqen dhe ashtu siç dëshiron.

Demokraci për mua do të thotë shkolla të mira ku nxënësit të mësojnë për vlerat demokratike, patriotizmin dhe të marrin kulturë e njohuri shkencore.

Duke mos mësuar asgjë me pahir ose dhunë. Është gonxhja e një vendi që garanton të ardhme dhe jetë të gjatë të Shqipërisë. Demokraci për mua do të thotë një ushtri e mirorganizuar, që mbron shtetin e vet, një shoqëri që ndërton karakterin e një shteti.

Është armata e njerëzve të një shoqërie demokratike ajo që të jep sigurinë që demokracia është aty kur duhet. Demokraci për mua do të thotë një administratë e mirë vendore që vepron pa ndikim politik tek qytetarët e vet, që siguron për ta pastrim, gjelbërim, ujë, transport dhe mbrojtje nga dukuri të ndryshme, një derë që hapet për të gjithë. Demokraci për mua do të thotë liri e medias.

Shpesh hasim ndarjen e mediave sipas përkatësive partiake.

Ky nuk është një element i mirë në demokraci. Media duhet e lirë dhe e pavarur. Gjithashtu demokraci për mua do të thotë tolerancë politike, dialog mes partive, pranim dhe respektim të ideve të të tjerëve, transparencë në veprime dhe pranim i humbjes. Për mendimin tim elita politike është koka që vendos në veprim trupin, pra vendos në veprim administratën.

E vërteta dhe dija janë të përbashkëta për të gjithë, ndaj nuk i përkasin askujt. Në një vend demokratik duhet të ekzistojë një kulturë e mirë politike. Ajo has mjaft pengesa në vendin tonë.

Rolin kryesor në kulturën politike e luan sistemi arsimor.

Qëllimi i sistemit arsimor është të formojë njerëz me botëkuptim të pavarur. Parimet që mësojnë në shkollë t'i zbatojnë edhe në jetë. Në një shtet demokratik duhet të ketë edhe rritje ekonomike dhe mirëqenie të shtetasve ku gjithkush të ketë punën si bazë për të mbajtur familjen.

Demokracia është fundi i dallaveve, i paaftësive, i padrejtësive, i gjithçkaje që kërcënon të dobëtin nga fuqia e më të madhit, është sistemi ku shteti ka përgjegjësi mbi qytetarët. Vendi ynë po ecën në rrugën e demokracisë, por unë e ndjej që ajo është e brishtë, shpeshherë lëkundet e nuk gjen rrugëdalje.

Atëherë vijnë të huajt e na marrin përdore.

E këtu mua më vjen keq për vendin tim, për demokracinë e vendit tim, për të gjithë ne. Deri kur politikanët do ta kuptojnë sa fatale është kjo për vendin, edhe për ta. Thua sikur nuk ka shembuj të vendeve me demokraci të konsoliduar nga duhet të udhëhiqemi.

Megjithatë Shqipëria po ecën mbrapa demokracive të vendeve të mëdha. Po marrim diçka që shpresojmë ta dimë si ta përdorim dhe të kthehet në punë për qytetarët e këtij vendi të mrekullueshëm që historia e ka dënuar. Duket sikur ne shqiptarët nuk po ndahemi dot nga e shkuara. Dëgjon të vjetrit gjithmonë, kur nuk ecin punët mirë: "në kohën e Enverit", "të ngjallet ai pa ta shikosh". Frikë, nostalgji apo patologji!?

Ndoshta duhet të shohim më tepër drejt të ardhmes, jo të ngushëllohem me të kaluarën, aq sa ajo të na bëhet si refren i jetës se sotme. Do gjendet gjithmonë

një laps për të shkruar të ardhmen e këtij vendi, por kurrë një fshirës për të fshirë të shkuarën, e cila vërtet ka qenë e hidhur.

Unë dhe brezi im do të përpiqet të gjejë këtë fshirës për të larguar nga kujtesa e njerëzve ato ide që nuk kanë kurrfarë vlere për jetën dhe të lartësojë ato vlera shqiptare që i shërbejnë së ardhmes, sepse koha që jetojmë nuk i përket nostalgjisë po demokracisë.

**Adela Vagollari**  
*Korçë*

## Ç'është demokracia për mua?

Ndoshta demokracia është një tendencë, një modë; tanimë thuhet shpesh se edhe në Perëndim, në vetë shtëpinë e demokracisë, ajo po kthehet në një “*vogue*”. E përmendur shumë nga mediat, e përdorur dhe propaganduar kaq shumë nga qeveritë, e përshkruar në vepra akademike e në fjalime të njohura, e studiuar dhe e mësuar nga breza të tërë studentësh, e kërkuar me ngulm nëpër protesta popullore, e shtrirë në aspekte të ndryshme, jo vetëm politike të jetës, e ardhur nga historia, shoqëruese e së tashmes, dhe e programuar të na shoqërojë edhe në të ardhmen, demokracia mbetet një koncept kompleks.

Kur bëhet një pyetje aq e thjeshtë si “Ç’është demokracia?” atëherë nuk duhet të habitemi kur të marrim aq shumë përgjigje relativisht të ndryshme, sa njerëz ka bota. Sidomos në kohën kur jetojmë ne, adoleshentët e të rinjtë, të mburjtur e të rritur me një koncept të tillë, e kemi nga pak demokracinë brenda vetes.

Rrjedhimisht e kemi të gjithë një përkufizim në kokë për këtë demokracinë “e famshme”, të lidhur drejtpërdrejt me konceptimin tonë për botën, me realitetin ku jetojmë, me idetë, ambicien dhe planet tona të mëdha shoqërore.

Kur t’i përgjigjem pyetjes së bërë, do të mundohem të vë rregull te të gjitha ato mendime e përkufizime që lindin menjëherë, si një refleks, sa herë përmendet fjala demokraci. Do të mundohem t’i largohem pak atij përkufizimit të ngurtë të përsëritur aq herë gjatë orëve të mësimi se “Demokracia nënkupton sistemin politik në të cilin sigurohet qeverisja (sundimi) i shumicës, apo më saktë, qeverisja (sundimi) në emër të shumicës së popullit, sistem në të cilin me kushtetutë dhe ligj është siguruar mundësia reale që qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën politike.”

Së pari demokracia është histori. Madje do të thoja se demokracia është histori njerëzore më tepër sesa politike. Si çdo dukuri tjetër njerëzore, edhe ajo ka lindur dhe zhvillimin e saj (për fat të mirë ende nuk e kemi parë fundin). Lindi në Greqinë antike, në qytet-shtetin e Athinës, u ngrit lart nga pionierët e demokracisë: Sokrati, Platoni, Aristoteli etj, në shek . V p.e.s.

Vazhdoi pastaj rrugën gjatë shekujve duke marrë edhe ngjyra romake, duke marrë edhe ngjyra mesjetare.

U shtri dalëngadalë në të gjithë Evropën Perëndimore, herë me revolucione, herë me kryengritje, herë me reforma, herë me revolucione të lavdishme, herë me konferenca paqeje.

Rilindi përsëri më fuqishëm se kurrë pastaj në SHBA dhe vetëm kohët e fundit, duke paguar çmime të rënda në luftëra të mëdha, u shtri gati në të gjithë botën.

E thënë tani shkurt, demokracia ka ecur bashkë me njerëzimin, prandaj më pëlqen tani ta cilësoj pjesë të historisë njerëzore. E rëndësishme në këtë aspekt është të theksoj një ide: atë se si një sistem i tillë, ka arritur t'i mbijetojë çdo ndryshimi politik, social, ekonomik, gjeopolitik ndërkombëtar.

Prandaj le ta quajmë fillimisht demokracinë si një lidhje me çdo kohë, një element pa kufi kohor dhe hapësinor.

Së dyti, demokracia është një sistem nga populli, për popullin, i popullit. Erdhëm kështu te kuptimi politik. Deviza e famshme e Linkolnit krijon përfytyrim më të mirë për demokracinë se sa e krijojnë qindra libra voluminozë. Ja sa e thjeshtë më duket atëherë demokracia si sistem nisur nga kjo devizë: një mënyrë qeverisjeje ku së pari, siç sugjeron vetë fjala, pushtetin e ka populli; ky pushtet ushtrohet me përfaqësues të dalë nga zgjedhje të lira e të ndershme; qeveria e krijuar ka si detyrë të punojë për të qeverisurit, të mbrojtë interesat, të drejtat e tyre; ka një barazi të gjithanshme; ka një bashkëpunim të vazhdueshëm politik dhe social mes qeverisë dhe të qeverisurve.

Kjo është në përgjithësi ajo e shkruara në letër, apo më mirë të themi, mënyra se si e përfytyroj unë demokracinë, pjesa tjetër i mbetet realitetit dhe praktikës.

Së treti, demokracia për mua, përtej çdo përkufizimi politik a social, është një mënyrë të jetuari, sidomos një mënyrë bashkëveprimi dhe bashkëjetese në shoqëri. Demokracia nuk është vetëm sistemi politik me të cilin qeveriset një shtet.

Ja disa shembuj: demokracia është mënyra me të cilën bashkëpunohet dhe merren vendime në një familje, demokracia është mënyra se si vendosin për lojën që do të luajnë një grup fëmijësh, për vendin ku do të festojnë një grup të

rinjsh, demokracia është mënyra e mësimdhënies dhe e zgjedhjeve të senatit në një shkollë, demokracia është mënyra apo sistemi që realizon veprimtarinë e një organizate bamirësie, e një kompanie biznesi, e një ndërmarrjeje, demokraci janë marrëdhëniet në shoqëri, barazia, respekti i ndërsjellë dhe puna për mbrojtjen e të drejtave dhe zbatimin e detyrave në një grup shoqëror .

Demokracia, atëherë, duke vazhduar mendimin e mësipërm është edhe shfaqje e globalizmit. E përhapur dhe e përdorur aq shumë sa përdoren sot “OK”, “Jeans”, “Facebook”, “Coca-Cola” e kështu me radhë, demokracia bëhet pjesë e jetëve tona dhe shumica e kësaj popullsie të madhe botërore e do demokracinë, qoftë edhe kur nuk e di kuptimin e saj. Demokracia është trendi politik i kohës, me përmasa universale, i pëlqyeshëm shumë, i aplikueshëm drejt më pak.

Demokracia, pastaj, është edhe liri. Shumë herë pranëvihen dhe ecin bashkë këto dy koncepte, jo pa të drejtë. Demokracia, të paktën në letër, të jep mundësinë të jetosh i lirë, pa kurrfarë varësie, të shprehesh, të informohesh, të arsimohesh, të dëgjohesh, të shkosh kudo, të realizosh ëndrrat, të ndërmarrësh një nismë të re sociale apo ekonomike, të mbrohesh në gjyq, të jesh i barabartë, të ndihesh njësoj, të praktikosh besimin tënd, të mësosh gjuhën tënde, të krijosh familje, të punosh, shumë më shumë se kaq. A nuk e kemi thënë të gjithë të paktën njëherë shprehjen: “Pse të mos e bëj këtë? Fundja jemi në demokraci !” E dimë se demokracia është liri, por sa mirë sikur të gjithë të dinim po kaq mirë se demokracia është edhe përgjegjësi!

Demokracia është përgjegjësi. Siç e thashë më lart, demokracia funksionon si një bashkëpunim i vazhdueshëm mes qeverisë dhe të qeverisurve, por edhe midis vetë të qeverisurve. Kjo do të thotë që të shlyejmë detyrimet ndaj shtetit, të respektojmë të drejtat e kujtdo, të kryejmë detyrat, të zbatojmë ligjet, edhe kur nuk na pëlqen, të marrim përgjegjësi qytetare, të reagojmë atje ku nuk na pëlqen, të mbështesim atë që na pëlqen, të votojmë, të ndihmojmë realizimin e planeve të mëdha shoqërore, të mos jemi indiferentë...e shumë më tepër se kaq. Kështu është e ndërtuar demokracia: një e drejtë, një detyrë.

E thjeshtë në dukje, e vështirë në zbatim. Bashkëpunim, përgjegjësi, vullnet! Për ta përmbledhur gjithçka (gjithmonë nëse mund të arrihet të përmblihet gjithë ajo mori kuptimesh të demokracisë) demokracia është një mënyrë të jetuari dhe të punuari bazuar në liri, barazi, drejtësi, respekt. Duket utopike, idealiste, ndërkohë që e famshme është edhe një pikëpamje tjetër më realiste, ose një vështrim më i errët, që e sheh demokracinë si regjimin më të keq, përveç të gjithë të

tjerëve që njerëzimi i ka provuar kohë pas kohe. Le ta hapim syrin realist dhe ta pranojmë sa shumë probleme ka sot demokracia, por le të mos harrojmë ëndrrat, idealet dhe ambiciet, që kemi të gjithë si të rinj që jemi, e që lidhen fuqishëm me demokracinë.

Prandaj le ta cilësojmë kështu: Demokracia është një udhëtim, ndonjëherë rruga është e qetë, ndonjëherë aq e ashpër sa të tremb, të frikëson, të "shkatërro", por çdo hap është më afër idealit. Ne nuk kemi arritur ende atje, por jemi rrugës.

## Ç'është demokracia për mua?

Për mua demokraci do të thotë qeverisje nga populli. Në teori qeverisja e përsosur, ku populli vendos, ku populli cakton vetë fatin e tij. Po në ç'vend të botës praktikohet kjo teori ashtu si duhet? Në fakt, në asnjë. As në SHBA, as në vendet e Evropës perëndimore, që sot njihen si vendet më të demokratizuara në botë.

Çfarë mund të them atëherë për demokracinë në Shqipëri, duke ditur se këtu demokracia ka vetëm njëzet vjet që "praktikohet"? Shqipëria, si çdo vend tjetër i sapodalë nga një sistem totalitar, ka mjaft probleme për sa i përket zbatimit të demokracisë. E lindur dhe e rritur në këtë sistem paksa të shtrembëruar demokratik, mund të them se ky sistem ka ndikuar edhe në mënyrën sesi unë e shoh demokracinë. Demokracia duhet të jetë një përfaqësim sa më i denjë i popullit, plotësim i vullnetit të tij, nga populli për popullin.

Demokracia duhet të jetë sistem qeverisës i drejtë, ku ai që bën krime ndëshkohet, ai që punon paguhet, secili merr atë që meriton, e këto të kontrolluara nga një mekanizëm funksional, siç supozohet të jetë demokracia. Demokracia, qeverisja nga populli duhet të jetë me të vërtetë nga populli, jo të monopolizohet në duart e më të fortëve, njerëz të cilët janë të gatshëm të bëjnë gjithçka, mjafton që të mos cenohet pushteti i tyre.

Qeverisja duhet të jetë në duart e atyre që duan, munden dhe që e meritojnë të qeverisin. Po si mund ta pretendosh këtë në realitet? Apo të paktën në vendin tim, ku mbi 50% të votuesve nuk i njohin aspak planet elektorale të atyre që kandidojnë për përfaqësues. Nëse nuk i njohin, rrjedhimisht nuk dinë të zgjedhin, e nëse nuk dinë të zgjidhin, në duart e kujt do të ishte vendi? Një tjetër pikëpyetje. Nuk pretendoj demokraci absolute, do të ishte e pamundur, sepse çdo gjë kur vihet në zbatim ka të metat e veta, por ama për sa kohë që ky sistem qeverisës të cilin ne e quajmë demokraci është shumë larg demokracisë reale, atëherë më mirë të mos quhet fare kështu. Të paktën të mos gënjejmë veten.

Po të flisnim për demokracinë si sistem qeverisës, ashtu siç është hedhur në letër si ide, atëherë nuk do të kishte aspak vend për kritika. Do lavdërohej e

vlerësohej, çdo njeri do ndihej i kënaqur, i plotësuar me atë që demokracia i ofron. Por, nëse flasim për demokracinë e zbatuar, atëherë është tjetër gjë. Së pari mund të them se ajo mbivlerësohet. Je i lirë të votosh, të kesh një aktivitet privat, të përfaqësohesh popullin tënd, po tek e fundit ç'vlerë ka e gjithë kjo, kur të gjitha vendimet merren nga lart pa pyetur shumë për ty apo gjithë të tjerët si ti? Sado që një vend të pretendojë ta quajë veten demokratik, nuk do kishte asnjë vlerë nëse aty nuk zbatohen liritë themelore të njeriut, nëse nuk ka kushte bazë për jetesë, apo të tjera të përcaktuara nga demokracia.

Vetëm emri "demokrati" nuk duhet të jetë mjaftueshëm për t'u kënaqur. Duhet zbatuar një më një të gjitha kriteret që kërkohen nëse do ta quash të tillë. Dhe kjo demokracia e zbatuar, përveçse mbivlerësohet, ndodh që edhe të keqkuptohet. Nuk e thotë demokracia se je i lirë të bësh çfarë të duash, të vrasësh e të vjedhësh, apo qoftë edhe të drogohesh, që është diçka krejt personale. Demokracia thotë se mund të jesh ti ai që qeveris, por jo të përdorësh çdo mjet të mundshëm a të pamundshëm që të arrish tek pushteti, e pastaj të mos e lëshosh më deri sa të vijë dita të dalësh në pension. Demokracia, njerëz të dashur, është qeverisje nga populli, qeverisje e drejtë, qeverisje në të mirë të popullit, qeverisje që sjell zhvillim, qeverisje që nxit vlerat, qeverisje që i jep mundësi të barabarta çdo qytetari.

Por pavarësisht gjithë këtyre, sinqerisht dyshoj se demokracia e vërtetë do zbatohet ndonjëherë tamam ashtu siç është.

Do doja shumë të ndodhte, por mendoj se është e pamundur.

**Gentiana Caco**  
*Korçë*

## Ç'është demokracia për mua?

Në këtë temë do të shpreh mendimet e mia ashtu siç unë e mendoj. Duket shumë e vështirë që të gjesh një fillim për të shkruar një ese, ku të shprehësh mendimin tënd sepse të vjen në mendje më mirë fundi sesa fillimi. Frymëzimi për të shkruar me vjen teksa rri me familjen.

Po rrija me familjen si çdo ditë tjetër. Kishte filluar një emision në të cilin debati kryesor ishte fjala "demokrati". Nuk e kisha mendjen tek televizori, po mendoja shumë gjëra në kasetën e harresës e cila ndodhej në trurin tim. Si shumë adoleshentë të tjerë, as unë nuk po i kushtoja rëndësi emisionit. Kur dëgjova fjalën demokraci u përmenda, sepse m'u kujtua tema e esesë që duhet të zhvilloja. Më pas ia kushtova kohën emisionit dhe po e dëgjoja me vëmendje.

Disa nga pyetjet që shtroheshin aty ishin: Ç'është demokracia si term? Kërkohej dallimi midis demokracive në vendeve të ndryshme, si dhe opinioni personal i të ftuarve. Po më tërhiqte vëmendjen debati ndaj pyeta babin: "A ekziston ndonjë vend demokratik në të vërtetë, apo thjesht flitet për gjëra që vetëm mendohehen? Ai mu përgjigj: "Një vend quhet demokratik kur e tregon demokracinë që në themelet e tij". Vazhdova të dëgjoja emisionin dhe në të u përmend emri Norvegji. Nuk e dija që Norvegjia qëndronte në vend të parë në zhvillimin e një demokracie të vërtetë. Po e mendoja se çfarë kishin bërë si shtet që qëndronin aq lart. Me aq di se është demokratik ai vend, që është i zhvilluar ekonomikisht.

S'po e besoja që e kisha gabim për aq kohë, prandaj dhe u ngrita dhe shkova në dhomën time. Hapa kompjuterin dhe fillova të kërkoj, fillimisht se çfarë është demokracia si koncept, që të sqaroja idetë e mia. Prita sa kërkimi u arrit dhe lexoj; që fjala demokraci do të thotë qeverisje kushtetuese, legjitimim demokratik i pushtetit politik, ndarje e pushtetit shtetëror njohje dhe respektim i të drejtave politike dhe civile. E kuptova që e kisha gabim. Prandaj dhe përsëri kërkova në internet dhe shikoj që vendi i parë ishte Norvegjia, kurse Shqipëria në vendin e 82. Meqë duhet të shprehja mendimin tim për sa i përket demokracisë them të krahasoj këto dy vende me njëra-tjetrën.

Kuptova se Norvegjia qëndronte në fillim, dhe Shqipëria në vendin e 82. Norvegjia

duhet t'i ketë përmbushur të gjitha kriteret që ekzistojnë në termi "demokraci". Që një vend të jetë demokratik ai duhet të dallohet në çdo fushë të zhvillimit dhe aspekt të fjalës. Këtë gjë Norvegjia e ka treguar si në politike, ekonomi, sport dhe shumë të tjera. Rasti i fundit ka qenë në futboll në një ndeshje të luajtur me Shqipërinë. Rezultati ishte negativ për sa i përket Norvegjisë, 0-1. Edhe pse një humbje, në fushën e tyre, nga norvegjezët u tregua se e meritoni të ishin të parët në demokraci. Nuk pamë ndonjë reagim negativ. Ata u sollën si njerëz të qytetëruar sepse nuk gjuajtën në fushë me mjete të ndryshme, nuk shanë dhe nuk prishën lojën.

Kurse me Shqipërinë ka ndodhur krejt e kundërta. Që të jetë një vend demokratik e ka treguar që nuk e meriton. Sporti dhe politika janë kryesoret, sepse sapo shohin këto dy aspekte arrijnë të njohësh se deri ku mund të arrihet në aspektin negativ. Në politikë kemi korrupsionin, që ka mbuluar çdo gjë.

Atje ku ka korrupsion çdo gjë duket mjaft banale, edhe ndeshjet të cilat çdo ditë po i mësojmë, se kanë qenë të trukuara. Në vendin tonë kjo gjë ekziston thjesht si term, sepse që jemi në demokraci kjo gjë nuk duket. Që të kesh të bësh me demokracinë duhet të respektosh shtetin e së drejtës. Edhe kjo gjë nuk është arritur, se shteti shqiptar është si ajo makina që kur i çahet ndonjë gomë nuk ecën më, ose kur i prishen frenat të përplas e të bën copë, kjo gjë është treguar më mirë nga politikanët, të cilët sillen mirë dhe ndihmojnë deri në atë fazë sa marrin votat dhe pastaj s'të hedhin më sytë.

Rastet konkrete i kemi dhe sot, në prag zgjedhesh. Çdo anëtar partie i kujtoda krahu qoftë, i zhvillon mbledhjet e tij duke bërë deklarata e premtime si në përallat. Po na lodhin këto gjëra; shaj, shpif, thërrit, mallko! Mjaft më kështu Shqipëria ime! Shumë vende të tjera tek të cilat shohim zgjedhje ndryshe, nuk i kanë këto sjellje para popullit.

Jam thjesht një 16-vjeçare, e cila e ka jetën përpara dhe me këto që po shoh po gjykoj dhe mendoj për më vonë, nuk e di a do ndryshojnë kohët dhe a do ndryshojë Shqipëria? Për ditë si këto të sotmet nuk të merr malli t'i jetosh. Ditë dhe kohë të vështira më presin jo vetëm mua, por që të gjithë brezin tim. Për të ecur përpara kemi synime që na bëjnë të jemi dhe të dalim një hap përpara. Ne jemi nxënës dhe kemi dëshirë që me mund dhe sakrificë të arrijmë dhe universitetin, në degën që ne duam, por një universitet cilësor, ku të mbizotërojë merita dhe jo miku e paraja si po dëgjojmë rëndom.

Ne duam të dalim mësues, doktorë, financiarë, gazetarë etj. Për sa i përket kësaj

të fundit, për gazetarët e ardhshëm çdokush e ka me mëdyshje. A ekziston liria e fjalës, liria e shprehjes dhe liria e shtypit në demokracinë shqiptare? Ekziston një frikë, frikë e cila i bën gazetarët të ndahen në klane partish, ndoshta edhe interesi, gjithsesi ka rënë poshtë misioni. Të vetmit që i kanë përballuar sfidat dhe debatet e drejtpërdrejta, kanë qenë gazetarët që punojnë në emisionin "Fiks fare". Ata janë heronjtë e së vërtetës që ia thonë në sy fjalët pushtetarëve që mendojnë se e bëjnë këto kohë demokracinë.

Nuk më takon mua të flas dhe pse me gjykimin tim arrij shumë lart. Akoma cilësohem si një fëmijë, dhe ne fëmijëve nuk na merret shumë për bazë mendimi, bile ne 16-vjeçarët as nuk votojmë.

Janë shumë të rrallë ata persona që kanë kënaqësi të dëgjojnë një fëmijë të flasë me ndjenjë dhe pasion duke u përfshirë në debate. Kështu duket që kemi një brez të zgjuar dhe që meriton më shumë vëmendje. Po demokracia do të na çojë përpara dhe të ngjitemi më lart, apo edhe në brezat e ardhshëm do të jetë kështu? Po nuk u largua korrupsioni jemi për t'u kthyer në kohën e Enver Hoxhës!

Koha e Enverit ishte e rreptë por atë dhe ata që e jetuan nuk duan t'u rikthehet më. Brezi im e njeh vetëm nga historia dhe ato që tregojnë prindërit tanë. Ne duam demokraci të vërtetë, jo si ndodh në këtë demokracinë e sotme, ku nepotizmi i vendit nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim, po ia merr frymën shoqërisë shqiptare. Nga gojët e shumë njerëzve dëgjojmë se jemi në demokraci, se jemi të lirë dhe të barabartë. Sa ekziston demokracia liria dhe pavarësia në shtetin shqiptar? Është një pyetje që shtrohet për të mësuar më shumë, prandaj dhe një përgjigje kësaj pyetje po ia kthej me një pyetje tjetër.

A bën shteti shqiptar atë që duhet në mënyrë që liria, demokracia dhe pavarësia që të jenë të mundura? Për të folur për demokracinë ka shumë argumente që janë pro dhe kundër. Kjo, nëse flasim sesi ajo është në Shqipëri por edhe duke vazhduar krahasimin me vendet e tjera, duke i menduar këto terma për vendin tonë, si demokraci që jemi, kemi një ndërthurje të gjërave sa nuk i ndajmë dot.

Por unë shpresoj, kam shumë shpresë, se Shqipëria do të ndryshojë, se ne do të kemi mundësi që fjalën "demokraci" ta ndiejmë me të gjithë fuqinë që ajo përmban. Ne jemi vend demokratik dhe do t'ia arrijmë, me patjetër!

## Ç'është demokracia për mua?

Njeriu rritet me tingujt e përditshëm dhe mëson t' i bëjë të dashura edhe për të tjerët. Kjo është ajo çfarë na karakterizon ne dhe ciklin e jetës sonë. Ç'është demokracia për ne? Në vitrinat më të mëdha të bibliotekave botërore dhe në radhët e dendura shkronjore, heshtja ka pasuar fjalën dhe atë çfarë mendon njeriu mbi kuptimin për demokracinë. Kjo jo se nuk ka një term konkret, por vetëm nga fakti se çdo filozof i shquar ka dhënë atë shprehinë e tij bindëse dhe agregate së demokracia është vetë `liri` apo siç vjen në shqipen tonë nga greqishtja: sundim i popullit. Sokrati: identifikues i kësaj shprehje bëri që edhe sot të mbetet një thelb studimesh. Megjithatë kjo filozofi e futur thellë në mendjen njerëzore vjen në formën e lirisë. Liria: synim i pashmangshëm i demokracisë dhe pa kufizim mendimesh, shprehish e veprimesh. Ama lindin edhe pyetjet mbi ekzistencën e saj, pra a ekziston dhe nëse po, sa shumë? Nga mënyra se si kuptohet dhe nga kush kuptohet rrënja e demokracisë, reflektimi i ndryshimit është pozitiv dhe kompleks. Pozitiviteti që shfaqet në këtë rast tregon se çdo njeri që e do demokracinë, do dhe gëzon padyshim edhe lirinë. Çdo njeri e do lirinë kur do çdo gjë e rrethon dhe e sheh me dashuri. Pa dashur të përziejmë politikën mund të themi tashmë me plot gojën se demokracia fillon nga vetë genia njerëzore. Mbi të gjitha duhet pra, të nisemi nga vetja, që të shqyrtojmë së pari veprimet tona. Ne s' jemi oratorë që të gjithë, por ama as të humbur krejt nuk jemi, sepse as bota ku ne jetojmë s' është e gjitha e përsosur. Përderisa ne jetojmë me liri, do të thotë se ekzistenca jonë varet nga vetë mendimi ynë, nga reagimi, që shfaqim për një çështje të caktuar dhe nga matja e impulsivitetit. Ne jemi ata që bëjmë demokracinë. Demokracia s' është thjesht një fjalë më shumë e fjalorit të shkruar apo e atij të folur. Demokracia është gjithçka na rrethon.

Demokracia është përditshmëria jonë.

## Ç'është demokracia për mua?

Demokracia duhet të jetë ajo formë qeverisjeje në të cilën populli është i pranishëm gjatë gjithë kohës. Në të cilën populli është i pranishëm në marrjen e vendimeve, në qartësimin e larmishmërisë së interesave, në dhënien e opinionëve, gjithmonë në të mirën e tij.

Pjesëmarrja konkrete e qytetarëve në qeverisje lehtëson punën e qeveritarëve, pasi ata që janë në krye të shtetit duhet të ecin në bazë të kërkesave "të plotësueshme" të popullit.

Por kjo jo gjithmonë ndodh. Është e vërtetë që Shqipëria është një shtet demokratik, synimi i të cilës është të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian, arritjet e saj deri tani janë të pranueshme (anëtarësimi në NATO, liberalizimi i vizave, superstrada Durrës-Kukës –Morinë etj..), por sërish ka shumë për të bërë.

Jo i gjithë populli është i kënaqur nga kjo qeverisje, pasi ka njerëz të cilët janë serish të kapluar nga varfëria, gjendje në të cilën mungon ajo sasi e të holave për të blerë të mirat materiale. Thuhet se është e pashmangshme, thuhet se jo të gjithë njerëzit kanë aftësinë për të ecur me hapin e kohës. Kjo ndodh sepse Shqipëria është e zhvilluar kryesisht në qytete, ndërsa fshatrat në një farë mënyre janë të lënë pas dore.

Viti 1990, përmbysja e komunizmit, ardhja e demokracisë, shteti shqiptar hap sytë për të parë më mirë të vërtetën e hidhur, për të parë më mirë gjendjen e tyre të "mbaruar", kaluan 23 vjet, teknologjia ka përparuar, shkollat janë sërish më të avancuara, por varfëria nuk shmanget dot, kjo pasi demokracia shqiptare është ende një punë e pakryer.

Duket se në Shqipëri ende nuk është arritur të krijohet një sistem demokratik funksional. Në njëfarë mënyre varfëria ekziston edhe për shkak të pabarazisë, për shkak të veseve si pirja e duhanit, pijeve alkoolike, drogës e shumë dobësive njerëzore të cilat e çojnë popullin drejt varfërisë, humbjes së parave për hiçgjë duke shkaktuar humbjen e kursimeve dhe varfërinë.



Një tjetër shkak është papunësia, shkalla e lartë e të papunëve ka sjellë një gjendje të vështirë jetësore në vend. Varfëria është një fenomen shumëdimensional me pasoja të dëmshme dhe të pakalueshme nga individët të cilët gjenden në një situatë të tillë. Të ardhurat e ulëta, minimale në një familje ndikojnë si në anën ekonomike, ashtu edhe në atë kulturore dhe shoqërore. Një njeri i distancuar nga të tjerët nuk do ndjehej asnjëherë mirë në një rreth shoqëror më të emancipuar.

Demokracia jeton nga bashkëpunimi i qytetarëve me njëri-tjetrin. Tashmë baza në një demokraci është dija dhe njohuria, po t'i plotësosh kushtet e një mendjeje të ndritur, demokracia është ajo që hap dyert e suksesit. Veprimi sa vjen dhe bëhet më i madh, një ndër mundësitë më të mëdha për eliminimin e varfërisë është shkollimi, një mundësi, e cila i jepet kujtdo pa dallim race, feje apo gjinie...!

Pushteti nga populli, duhet te jete akoma me i fuqishëm, vetë populli s' duhet ta lejojë të drejtohet nga qeveritarë të cilët nuk ecin mbi bazën e nevojave, por mbi bazën e interesave.

Shqipëria do quhet shtet demokratik, atëherë kur varfëria të mos jetë më e pranishme në shoqërinë tonë, atëherë kur gjithçka të lulëzojë dhe vendi jonë të jetë vërtet i lakmueshëm.

Demokracia e përsosur nuk ekziston askund, po të ishte kështu, bota do ishte e përsosur!

**Neda Kallanxhi**  
*Korçë*

## Ç'është demokracia për mua?

Frymëzuar nga zhvillimet përherë e më pozitive të vendeve demokratike, që kanë përqafuar prej vitesh, dekadash e shekujsh këtë sistem lindin para nesh dy konceptime të saj në Shqipëri: demokraci ende në fazën fillestare të tranzicionit me mungesë zhvillimi ekonomik, politik e social apo demokraci, edhe pse jo fort e konsoliduar, por me hapa të dukshëm transformimi të gjithanshëm.

Padyshim që asgjë nuk mund të arrihet në perfeksion e aq më tepër demokracia në një vend, i cili ka ende të hapura plagët e së kaluarës. Sidoqoftë, unë mendoj se demokracia tek ne, megjithëse ende e brishtë, është gjithmonë në dinamikë e sipër.

Në një demokraci, organizohen zgjedhje të lira dhe të pavarura, që vendosin në qendër qytetarin dhe votën e tij. Nga ana tjetër, W. Churchill ka thënë: "Argumenti më i mirë kundër demokracisë është një bisedë 5-minuteshe me një votues të zakonshëm".

Ky konstatim është lehtësisht i konceptueshëm për vetë faktin se demokracia identifikohet me qeverisjen e popullit, cili zgjedh përfaqësuesit e tij përmes votës.

Kjo i jep atij të drejtën për të kërkuar përmbushjen e kërkesave të njëres palë dhe premtimeve të palës tjetër. Megjithatë është e qartë se mos-realizmi i këtyre pritshmërive ndesh në zhgënjimin e elektoratit e për pasojë humbjen e besimit për diçka ndryshe.

Prandaj duhet treguar kujdes që premtimet të mos mbeten thjesht një armë e fuqishme bindjeje gjatë fushatave politike, por zbatimi i tyre të bëhet synimi kryesor, që do të sillte përfitime të ndërsjella: një jetë më të mirë për qytetarin dhe një mandat më të gjatë qeverisës të forcës partiake në pushtet. Së dyti do të ishte tregues përveçse i qytetarisë, por edhe i arritjes së standardeve më të larta të bashkëpunimit "për hir të popullit", pranimi i rezultatit zgjedhor si vullneti i shumicës, e parashikuar kjo si një nga parimet kryesore të demokracisë.

Nëse François Hollande dhe Nicolas Sarkozy pranuan rezultatin e zgjedhjeve dhe si dy rivalë të denjë i shtrënguan dorën njëri-tjetrit, atëherë pse mos ndodhë kjo edhe tek ne?

Gazetarët, edhe pse përipiqen të sjellin ndryshime në mentalitetin politik, mbeten në përpjekje. Media, si pushteti i katërt, luan rol kyç në arritjen e standardeve demokratike. Duke qenë në avangardë të zhvillimeve qysh në embrion e si të tillë përgjegjës për transmetimin korrekt e koherent të çdo informacioni, ata e popullin me politikën. Pra, ata përbëjnë kanalet lidhëse në skemën e komunikimit.

Funksioni i tyre do të cilësohej më produktiv nëse mundësinë për të shprehur drejtpërdrejt mendimin dhe bindjen e tyre politike, do ta përdornin si qytetarë të denjë. Të jesh i politizuar nuk do të thotë të hiperbolizosh forcën politike që mbështet apo të sulmohesh vazhdimisht forcën tjetër. Përkundrazi liria e fjalës mediatike do të përbushte qëllimin e saj profesional nëse kjo fjalë do të shërbente për të nxitur forcat politike të zbatojnë programin e tyre elektoral.

Ka përpjekje të vazhdueshme për rritjen e rolit të OJF dhe atyre vullnetare në qeverisjen lokale e rajonale. Në vetë ekzistencën dhe cilësimin e tyre si jofitimprurëse dhe vullnetare, tregohet qëllimi human me dëshirën për ndryshim të mentaliteteve, tabuve dhe praktikave të gabuara në shoqëri.

Si të tilla, këto organizata mund të realizojnë ndryshime evidente për përfshirjen e shoqërisë civile në zgjidhjen e problemeve sociale të tilla si: dhuna në familje, barazia gjinore, emancipimi i gruas, apo mbrojtja e trashëgimisë kulturore e natyrore. Thellësia e çështjeve që ato trajtojnë dhe realizimet përkundrejt asnjë përfitimi financiar e bën misionin e tyre shumë human. Veç kësaj, veprimtaria tyre garantohet me ligjin 8788 dhe aktualisht numri i tyre është 900. Por, përveç ditëve ndërkombëtare si dita e mjedisit, e gruas, e familjes, kur OJF-të bëhen të pranishme në trajtimin e këtyre problemeve, duket sikur në periudha të tjera ato bien në hije e nuk shfaqen, pavarësisht nga roli kyç në garantimin e standardeve demokratike. Ndoshta kjo tregon mbështetjen e pamjaftueshme të shtetit shqiptar. Në mendimin tim, e mira do të ishte intensifikimi i veprimtarisë së OJF-ve. Është treguar qartë, që këto organizata janë primare në përfshirjen e mendimit të shoqërisë civile, duke edukuar dhe nxitur promovimin e vlerave njerëzore e natyrore.

Rinia shqiptare konsiderohet si forcë vitale në zhvillimin e vendit. Që Shqipëria

të bëjë kalimin nga faza e tranzicionit në atë të lulëzimit demokratik, duhet të pranohen ide novatore, të cilat mund të sjellin ndryshimin e kërkuar.

Jo rrallëherë të rinjtë shpërfillen sepse mendimet e tyre cilësohen të cekëta, duke paragjykuar moshën e re. Shumë nga kërkesat e tyre mbeten pa përgjigje, kur në fakt kjo grupmoshë ka shumë ide produktive. Nëse këto ide do të viheshin në praktikë, të gjithë shqiptarët do të përftonin jetë më të mirë. Nisur nga kjo, shumë nga politikanët shqiptarë, të vetëdijshëm për përfitimet në shfrytëzimin funksional të këtij potenciali konstruktiv, po nxisin këtë grupmoshë të rrisë pjesëmarrjen, duke krijuar mundësi të reja veprimi.

Është fat të kesh “trustin e trurit rinor”, me shpresën për një shoqëri që transformohet, duke adoptuar mentalitetin e ri demokratik.

Si sintezë të përgjithshme, Shqipëria, si mikpritëse dhe akomoduese e demokracisë për mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe të pavarura, me angazhimin e gazetarisë në sjelljen e ndryshimeve të opinionit politik, me përpjekjet për rritjen e rolit të OJF-ve në qeverisjen lokale dhe rajonale, dhe së fundmi, me konsiderimin e rinisë shqiptare si forcë vitale në vend, e sheh demokracinë në dinamikë e sipër.

## Ç'është demokracia për mua?

Demokracia është një formë qeverisjeje, e cila përmban një tërësi rregullash dhe procedurash që vijnë si rezultat i një akordi ose kompromisi me qëllim zgjidhjen paqësore të problemeve midis aktorëve socialë politikisht të rëndësishëm dhe aktoreve të tjerë të institucioneve, prezentë në arenën politike. Por më qartë demokraci do të thotë që pushteti vjen nga populli, i përket popullit dhe duhet të përdoret për popullin.

Është kjo formë qeverisjeje që ua ngroh zemrën me shpresa dhe iluzione të gjithëve: femrave, të varfërve, njerëzve me ngjyrë, pakicave etnike etj. Demokracia, në bazë të ligjit themelor të shtetit siç është kushtetuta, barazon të drejtat dhe përgjegjësitë e të gjithë shtetasve, duke siguruar një bashkëjetesë të harmonizuar ndërmjet tyre.

Ka njëzet e tre vjet që Shqipëria ka dalë nga një regjim totalitar, që ushqueu popullin me dhunë fizike e psikologjike, servilizëm, padrejtësi, gënjeshtër, varfëri dhe izolim. Ishin këto metoda të rrepta, të cilat për një gjysmë shekulli shuan shpresën për liri, zhvillim dhe drejtësi tek populli ynë i vuajtur. Mjafton të hedhim sytë nga e kaluara e hidhur dhe menjëherë shfaqen imazhe te frikshme të vuajtura nga atdhetarët tanë, si burgjet e pështira të diktaturës, pllaka të gjakosura me pafajësinë e qindra shtetasve, shkrime realiste e të zbardhura nga hijet e së vërtetës duke zbardhur atë mantel të rëndë errësire dhe vdekjeje.

Po vitet '89 dhe '90 rrëzuan atë bllokade, që ndaloi frymëmarrjen e Shqipërisë për pesëdhjetë vjet, me mendimin për të ecur përpara, përkrah shteteve të botës, pa mëri dhe inate të vjetra. Kështu për këto njëzet e tre vjet, Shqipëria bëri ndryshime radikale duke filluar që nga përcaktimi i formës së qeverisjes në republike parlamentare, ndryshoi kushtetutën, nga një parti që vendoste gjithçka në një sistem shumëpartiak, ndërmoi reforma për sektorë të ndryshëm të ekonomisë, u vendos tregu i lirë, iu dha prioritet pronës private etj.

Ndonëse kanë kaluar dy dekada që nga periudha e regjimit totalitar, në shoqërinë tonë gjenden ende copëza të trishtat të atij realiteti drithërues, mendime prapanike që ndalin ritmin e shpejtë të zhvillimit të demokracisë. Ne shqiptarët

nuk e kemi kuptuar drejt termin demokraci në të cilin përkrah të drejtave renditen dhe përgjegjësitë, ku përpara ligjit jemi të gjithë të barabartë. Ne ende nuk kemi arritur të çrrënjosisim njollën e zezë totalitare që mban peng zhvillimin e vendit tonë.

E them këtë pasi korrupsioni është ngërç kryesor në zhvillimin e demokracisë në vendin tonë. Do të doja shumë që vendi im të ecte përpara, të anëtarësohej në BE, të kishte një ekonomi më të qëndrueshme, një siguri më të lartë, dhe barazi mes shtetasve të tij.

Shpresoj që në një të ardhme të afërt të ndez televizorin dhe të mos dëgjoj më lajme që tregojnë vrasje, aksidente të panumërt, dhunë në familje, korrupsion në administratën shtetërore por veç lajme të mira, nga ato që të qetësojnë dhe të bëjnë të ndihesh krenar për vendin tënd.

I vlerësoj shumë përpjekjet e ndërmarra nga organizma të ndryshëm ndërkombëtarë për të siguruar një mirëfunksionim të demokracisë. Por për t'u arritur kjo, mendoj se duhet ndërgjegjësimi i vete popullit shqiptar. Janë ata që duhet të kuptojnë se fuqia e qeverisjes se vendit është pikërisht në duart e tyre. Janë ata të cilët i zgjedhin aktorët politike që përfaqësojnë kërkesat e tyre.

Me pëlqen shumë guximi i mediave, paçka se nuk kanë ende një liri të plotë, sepse censura e politikës arrin të dominojë mbi vullnetin e lirë të gazetareve. Do të doja të falënderoja me gjithë shpirt të gjithë ata publicistë, intelektualë, apo emisione televizive që pasqyrojnë situata aktuale pa marrë parasysh se interesat e kujt dëmtojnë.

Është meritë e tyre që para së gjithash vendosin interesin publik duke menduar për të gjitha shtetasit në nevojë.

Por si gjithmonë aty ku ka merita ka dhe kundërvëniet. E pohoj këtë sepse një zë i fuqishëm i kërkesave të popullit janë dhe sindikatat, të cilat në shumë raste heshtin përballë padrejtësive duke harruar misionin e tyre. Organizatat për mbrojtjen e mjedisit nuk ngrënë zërin për barbarizmin që u bëhet mjedisve të gjelbra apo hapësirave pyjore, shoqatat për dhunën ndaj femrave nuk e tregojnë dhe aq rolin e tyre në jetën shoqërore duke u përqendruar vetëm në zonat urbane, e duke lënë mënjanë zonat rurale.

Sepse aty nevojia për informacion është më e madhe dhe koha ecën më me ngadalë për shkak të traditave dhe zakoneve të vjetra. Janë këta mjediset ku

femra dhunohet në mënyrë të pamëshirshme.

Mendoj se po të kuptonim se demokracia është një e mirë e përbashkët dhe të bindemi ndaj ligjit, situata e zhvillimit të demokracisë do të ishte më ndryshe. Ne harrojmë se për t'u kuruar në një qendër shëndetësore shtetërore, nuk kemi nevojë të paguajmë ryshfete përveç taksave të njohura apo që të zëmë një vend pune duhet të paguajmë një shumë të madhe parash kur kualifikimet duhet të bëhen në bazë të aftësisë, apo të pranojmë të bëjmë pazarllëk me votën tonë të lirë dhe të fshehtë.

Apo le të ndalojmë tek gjykatat shqiptare të cilat vetëm organe drejtësie nuk mund të konsiderohen, sepse nëse dëshiron të fitosh një çështje gjyqësore, mjafton të paguash një shumë të madhe edhe nëse nuk ke të drejtë. Ne këtë vend mund të mos kesh një pronë private por mund të të dhurohet një e tillë, mund të kesh kryer një vepër penale por mund ta kryesh dënimin vetëm për një afat kohor krejt të shkurtër, ose një çështje gjyqësore mund të zgjasë me vite. Dhe e gjithë kjo vetëm falë parasë, e cila mesa duket mund të blejë gjithçka.

Me gjithë këto, politikanët tanë kanë guximin të debatojnë për çështje qesharake, duke harruar se ka shumë familje që nuk kanë as bukë për të ngrënë, shumë të papunë, punonjës që nuk paguhen, të sëmurë që nuk kanë para për t'u shëruar e shumë e shumë të tjera. Të gjitha këto probleme lihen mënjanë veçse për të luftuar për pushtet që të realizojnë interesat personale. Në Shqipëri mbizotëron një diktaturë me fytyrë demokratike!

Sepse realitetit nuk duhet t'i hedhesh fjalët e gënjeshtres, as gënjeshtres nuk duhet t'i mësosh fjalët e realitetit.

Duhet të ndryshojmë idenë se ndryshimet e mëdha vijnë vetëm nga aktorët politikë. Jemi ne ata që bëjmë ndryshimet e mëdha sepse ndryshimi fillon nga secili qytetar i thjeshtë.

Kështu që te gjithë le të ndiejmë shqip, sepse dashuria për vendin tonë do të jete shtyssa më e madhe për ne. Kuptimi i ekzistencës për shqiptarët është dashuria dhe puna për vendin e tij.

Le ta mendojmë demokracinë si një recetë për një jetë sa më të mirë, e cila udhëzon veçse gjëra të shëndetshme, si një shprese e cila ledhaton dhe nxit ëndrrat e dëshirat tona, si një melodi të ëmbël që ushqen shpirtin veçse me dashuri dhe pozitivitet dhe në këtë mënyrë nuk do të reshtim së punuari për një Shqipëri më të bukur...

**Enida Bici**  
*Gramsh*

## Ç` është demokracia për mua ?

Demokrati. Fjalë të cilën e ndeshim shpesh, të cilën e hasim kudo, në televizion, radio, gazeta, fjalime politike e deri tek bisedat e vogla të njerëzve të thjeshtë. Thellë-thellë, çfarë është demokracia ? Çfarë përfitohet dhe arrihet nëpërmjet saj? Në mendje më vijnë mijëra përgjigje. Për mua demokracia është liri, liri zgjedhjeje, mendimi, besimi dhe veprimi.

Demokracia është ajo formë largimi nga e kaluara e dhimbshme e vendit dhe popullit tonë. Është ajo formë qeverisjeje, ngushëllimi i së tashmes monotone në të cilën jetojmë.

Por ne jetojmë të gjithë të kapur pas kësaj fjale, edhe pse nuk veprojmë në bazë të ligjeve e rregullave të saj. Pasi ato liri që ofrohen nga vetë fjala "demokrati" keqpërdoren. Është zhgënjyese të shohësh kur hap pas hapi iu rikthehem atyre viteve të errët të së shkuarës historike. Jetojmë në shekullin e XXI, në vitet e lira demokratike, e në fakt kjo nuk ndihet aspak. Pasi nëse thua diçka ndryshe, kërcënohesh. Nëse mendon ndryshe, do të gjendesh e kredhur në masën e gjere duke humbur unin tënd, e nëse vepron ndryshe, vritesh. Po, po jetojmë në këto vite, vitet demokratike, nëse je vetvetja paragjykoresh, komentohesh e shndërrrohesh në një qenie krejt ndryshe nga ajo që je.

Dhe thuhet se jetojmë në demokraci ?

Të jetë kjo demokracia? Aspak. Kurrë. Demokracia jonë është thjesht ajo fasada dhe logoja e jashtme e këtij vendi. Është ajo gënjeshtër, ku të gjithë e kanë më të lehtë ta besojnë e të mendojnë se po veprojnë në bazë të saj .Pasi të jetuarit në demokraci, për mua do të thotë drejtësi, liri, ndryshim. Ndryshim në çdo aspekt, ekonomi, industri, turizëm, mentalitet, ide, liri deri aty ku shkon liria e një qytetari tjetër e drejtësi pasi një shtet pa institucione demokratike apo pa drejtësi në organet e tij nuk mund të funksionojë. Por realiteti nuk i tregon këto fjalë, pasi ky realitet është një shembull i përkryer i formës qeverisëse në të cilën jetojmë .

E kjo formë nuk përkon aspak me parametrat e fjalës demokraci. Ku gjithnjë e më shpesh dëgjojmë e lexojmë për vrasje te shumta, dhunime, trafikime, kërcënime e çdo lloj vepre tjetër negative e cila nuk e ka marrë kurrë ndëshkimin e duhur, duke u lënë kështu, në ato dokumente të mbuluara nga pluhuri i harresës .

Ndoshta dikush mendon se çdo gjë do te rregullohet me kalimin e kohës. Gjithçka do të rregullohet nesër. Kjo është bota në të cilën jetojmë, kjo është mënyra në të cilën veprohet në të tashmen tonë.

Thuhet demokraci, por pas saj fshihet më shumë. Dhe a është pikërisht kjo ajo që ne dëshirojmë? Më lindin pyetje të shumta, të cilat ngatërrohen me përgjigje, ide dhe fjalime nga e kaluara të cilat të gjitha së bashku më shtyjnë të mendoj se vetëm idetë dhe veprimet që ne të gjithë mund të bëjmë për zhvillimin sa më demokratik të vendit tonë janë te panumërta .

Sepse jemi pikërisht ne ndryshimi, ne jemi në ata të cilët nëpërmjet veprimeve tona dhe formës së të menduarit kemi pushtetin, duke formuar demokracinë, duke formuar të ardhmen e demokracisë. Jemi ne, populli i thjeshtë por që kemi te drejtën te zgjedhim për një zgjidhje sa më demokratike.

Çdo gjë varet nga ne. Varet nga ne nëse duam ende të jetojmë në këtë mënyrë, të dhënë pas fjalës demokraci apo të rendim pas kuptimit dhe zbatimit te saj.

Dhe pyetjet, hipotezat që mund të hidhen do të na ngatërrojnë dhe do të na zhysnin në një vorbull mendimesh duke u përpjekur për të arritur në një zgjidhje, në kuptimin sa me të sakte të fjalës “demokraci”. E mendja më rikthehet në vitet e tranzicionit te ato shndërrime demokratike në Shqipëri në vitet 1990-2013.

Në ato vite “të lumtura” për të gjithë ne. Diku kam lexuar rreth shkëndijave të para të lëvizjes demokratike, për atë shturje të tregut socialist, për lëvizjen e studentëve grevistë.

Te gjitha këto më bëjnë të kuptoj rëndësinë e te qenit në demokraci. Luftën e madhe që është bërë nga të parët tanë, që ne, pasardhësit e tyre të jetojmë te lirë, në paqe dhe në harmoni me demokracinë.

Dhe a jemi ne duke e ruajtur atë rendin e duhur te demokracisë? Apo ndoshta ne kurrë nuk e kemi arritur këtë fjalë? Janë vërtet të dhimbshme ato momente e kujtime të së shkuarës së regjimit komunist e atij fashist që popullit shqiptar

i është dashur të durojë e jetojë.

Janë dashur vite të tëra plot ëndrra e luftë që të arrihej diçka për Shqipërinë, një ndryshim për të, si një vlerësim ndaj asaj që ajo na ka ofruar ne, popullit të saj. Ku duhej pikërisht shkëndija e parë e lëvizjes demokratike e cila ishte emigracioni politik, mjeti i cili parapriu proceset demokratike në Shqipëri.

Por merita më e madhe i takon lëvizjes studentore, studentëve të cilët u futën në një grevë urie pa afat duke u angazhuar në një luftë për goditjen e komunizmit, në një luftë për jetë a vdekje .

E historia e vazhdon rrjedhën e saj, sikur asgjë të mos kishte ndodhur.

Atëherë Shqipëria e vogël ndodhej në fillimet e jetës demokratike, ndodhej në një vështirësi të tillë për të parën here. E pasojat e saj ishin të shumta, të gjitha duke rënë mbi ne, mbi popullin e saj, mbi shqiptarët. Por duke parë të shkuarën e vendit tim, duke rikujtuar historinë, vallë a ia vlen që ne të sillemi në këtë mënyrë, duke mos përfillur sistemin tonë demokratik, e duke u sjellë jashtë normave të tij?

Dhe është po ajo, Shqipëria, e cila pas vendosjes së demokracisë ka pësuar ndryshime të thella politike, ekonomike dhe shoqërore duke u përpjekur te ndërtojë në këtë mënyrë institucione demokratike, raporte “demokratike “shtet –qytetar.

E megjithatë, zhvillimet e fundit kanë treguar se në rrugën drejt demokracisë ka ende probleme që duhen zgjidhur. Pasi forcimi demokratik lidhet ngushtë me vendosjen e sistemit demokratik, ndërtimin e shtetit ligjor, me funksionimin e sistemit shumëpartiak dhe me zgjedhjet e rregullta.

E pas të gjithave, është e vështirë të mendohet ndërtimi i një demokracie të vërtetë pa një rimëkëmbje ekonomike, sepse paaftësia e qeverive të njëpasnjëshme për të siguruar një stabilizim ekonomik, për të lehtësuar varfërinë e skajshme e për të zgjidhur problemet e ngushta ekonomike-sociale-politike, mund te çojë në një zhgënjim te njerëzve ndaj demokracisë.

E kjo demokraci ngrihet vetëm në qoftë se bëhen përpjekjet e duhura për zgjidhjen e problemeve aktuale të vendit tonë. Kjo mundësi arrihet, ne mundemi, pasi ajo çfarë Shqipëria mund të na ofrojë e na ka ofruar ndër vite janë të shumta.

Kjo falë edhe pozitës së saj gjeografike, relievit, pasurive të ndryshme si dhe falë traditave, zakoneve të trashëguara brez pas brezi, e kanë bërë Shqipërinë një vend tërheqës, mikpritës dhe mbi të gjitha e kanë bërë atë një vend të denjë për të mbajtur titullin demokraci.

Dhe sikur kjo të mos mjaftonte, ne i jemi futur asaj rruge vite më parë, dhe ndodhemi ende në rrugën e vështirë drejt demokracisë, me shpresën dhe idenë se një ditë do të arrihet të thuhet me plot gojën se jemi një vend demokratik, ku çdo ligj e rregull zbatohet e njihet nga të gjithë. Dhe çfarë është demokracia në fund të fundit?

Demokracia për mua është ajo fjalë e fortë, të cilën e ndjen teksa e thua, e cila të fut të dridhurat duke të rikujtuar të shkuarën dhe të fal atë ndjenjë qetësie drejt së ardhmes, duke thënë e lumtur se jemi një vend demokratik, i afte t'u falë shumë pasardhësve tanë. E ardhmja e vendit tim është padyshim sistemi demokratik i vendosur nga njerëz të aftë dhe të bindur për mirëqenien e vendit, e mbi të gjitha, të popullit shqiptar.

E ardhmja e vendit tim është demokracia, demokracia e vërtetë.

**Griselda Meti**  
*Lezhë*

## Ç'është demokracia për mua?

Demokracia është një formë e jetës politike të një rendi sundues popullor. Përkufizimi i fjalës përkrahur vetëm se kush do të sundojë dhe përkundër interpretimeve të ndryshme, ai nuk jep përkrahime se si duhet të qeverisë i zgjedhuri.

Sipas mendimit tim “metoda demokratike” është instrumenti institucional me qëllim që të arrihet në vendime politike, në bazë të të cilave individë të caktuar marrin të drejtën për të vendosur në bazë të një konkurrence që ka për qëllim marrjen e votave nga populli.

Dua ta vë theksin jo vetëm tek konkurrenca, por edhe tek vlerat, tek ekzistenca e shumicave dhe e pakicave konkurruese, të cilat shërbejnë për të siguruar ekzistencën e këtyre të parave me anë të sistemit të votës.

Mendoj që një regjim demokratik për sa i përket zgjedhjeve duhet të ketë të paktën zgjedhje të përgjithshme që të përfshijnë si meshkujt ashtu edhe femrat, të gjitha etnitë në një popullsi, e quajtur ndryshe elektorat.

Do ta përkrahja demokracinë si një tërësi rregullash dhe procedurash që vijnë që vijnë si rezultat i një akordi ose kompromisi me qëllim zgjidhjen paqësore të problemeve ndërmjet aktoreve sociale politikisht të rëndësishëm dhe aktorë të tjerë të institucioneve të pranishme në arenën politike. Përkufizimi që sapo dhashë na lejon të shohim më mirë një aspekt shumë të rëndësishëm të demokracisë, aspekt ky që shpesh është lënë pas dore ose është nënvleftësuar: demokracia është një regjim i karakterizuar nga rregulla dhe institucione që ekuilibrojnë parime të ndryshme.

Demokracia ka nevojë për një akord bazë mbi rregullat që do të vendosen dhe në të njëjtën kohë duhet të pranojë të mos qenit dakord dhe konfliktet mbi përmbajtjen e këtyre rregullave. Demokracia duhet të pranojë pasigurinë në lidhje me rezultatet e arritura, por ajo ka nevojë edhe për sigurinë e rregullave të vendosura prej saj, në mënyrë që pasiguria të bëhet relative dhe e limituar.

Demokracia duhet të karakterizohet nga përfaqësimi sa më i gjerë i interesave

dhe e identiteteve në vendet e vendimmarrjes, në parlament dhe në asamblëtë rajonale dhe lokale, por në të njëjtën kohë nuk mund të heqë dorë nga efikasiteti i vendimmarrjes, i cili është shumë i vështirë në rastet kur duhet të arrihet një përfaqësim sa më i mirë i komunitetit.

Ne fakt demokracia mbart me vete një paradoks, pasi sa më i fortë dhe i konsoliduar të jetë konsensusi mbi të cilin bazohet, aq më shumë konflikt mund të përballojë ajo.

DEMOKRACIA ... ka fjalë e fjalë pa mbarim për ta përshkruar.

Por këta ishin disa nga mendimet e mia lidhur me të.

## Ata thonë..

Nocioni demokraci ka të bëjë me këto pika: Sovranitet i popullit, pushtet i shumicës, respektim i të drejtave të pakicës, barazi përpara ligjit dhe zbatim i ligjit, pluralizëm, tolerancë, bashkëpunim dhe kompromis. Çdo individ i kësaj shoqërie nuk mund të kërkojë të drejtat e tij, pa realizuar detyrat e tij, sepse çdo gjë së pari fillon nga vetja, pastaj kërkohet nga të tjerët. Në të kundërt, shteti demokratik nuk ekziston.

**Ersila Ahmetaj  
Lezhë**

Zhvillimin e demokracisë për mendimin tim e pengon një dhe vetëm një gjë, futja në organet vendimmarrëse e njerëzve të paaftë. Në mbështetje të demokracisë me fjalë janë të gjithë, por me vepra janë vetëm disa.

**Ilvi Deda  
Pukë**

Jemi një vend demokratik, por në të vërtetë nuk zbatojmë rregullat e demokracisë.

**Rinada Asllanaj  
Pukë**

Shpesh shqiptarët fajësojnë shtetin për të ardhurat e tyre, a thua se është detyra e shtetit që ata të marrin të ardhura pa bërë asnjë përpjekje, dhe harrojnë se shteti janë ata vetë. Shteti nuk ka shkruar asnjë ligj ku thuhet se ligjet duhet të shkelen, se shqiptari nuk duhet të dojë shqiptarin e se për të ndihmuar njëritjetrin na duhet të paguajmë paradhënie.

Nuk ka asnjë ligj ku thuhet se të gjithë pa përjashtim duhet të shkojnë në universitet pavarësisht nëse ndihen të aftë apo jo. Askush nuk na ka thënë se

për të hyrë në universitet duhet të paguajmë edhe përveç taksës apo se dhe për një shërbim mjekësor duhet të japim lekë. Por, jemi ne që i kemi mësuar pushtetarët në këtë mënyrë, ndaj hapi i parë që duhet të bëjnë shqiptarët është të ndërgjegjësohen se nuk ka asnjë arsye pse të vazhdojmë të bëjmë këto gabime në të ardhmen.

Të gjithë mendojnë se pothuaj çdo gjë rrotullohet rreth lekut, një kartëmonedhë me anë të së cilës mund të blesh një mori gjërash. Por, e vërteta është se pasuria vjen nga shëndeti. Pa një shëndet të mirë letrat nuk kanë asnjë vlerë. Problemi qëndron se për një shëndet të mirë, në Shqipëri duhet të paguash shumë shtrenjtë. Edhe për një gjilpërë të duhet të paguash. A nuk është kjo e tepërt?

**Kristina Demollari  
Korçë**

Shumë vende, ndonëse kanë sisteme demokratike, nuk kanë demokraci të vërteta. Këto janë vende në të cilat në një periudhë kohore të gjatë, ndoshta për dekada të tëra, qeveris një elitë e caktuar.

Një pyetje më mundon: a është kjo “shoqëri demokratike” thjesht një reflektim i klasës tonë politike? Apo mos është vetë “shoqëria demokratike” ajo që e ka projektuar këtë klasë politike?

**Romina Marku  
Lezhë**

Mos e kërkoni demokracinë në gjëra të pamundura, në dimensione të huaja, jetojeni aty ku dora dhe mendja juaj punon për të tjerët, për miqtë, familjen, për ata që janë ndryshe nga ju.

**Gjyste Ndoka  
Lezhë**

## Demokracia jonë adoleshente

Mendoja se kur të rinjtë shkruajnë për demokracinë ata ndoshta dalin disi nga hareja e moshës, bëhen më seriozë se sa u takon dhe më hijerëndë, me pak fjalë prisja të lexoja esse të shkruara nga “gra dhe burra të vegjël” me terma të huazuara nga bota e të rriturve. Isha gabuar. Ato shkrime, sidomos ato fituese, janë vërtet të mrekullueshme. Pyetje me një zgjuarsishtësi të sinqertë e çarmatosëse, që na shtien vërtet në mendime. Gjimnazistët shkruajnë për demokracinë si një e drejtë natyrale që i takon gjithkujt, pra edhe atyre vetë dhe kjo demokraci, që shohin, është një e drejtë që në fakt u është mohuar. Nga kush? Nga ne, të rriturit.

Në fakt, pyetjet dhe gjendjet që përshkruajnë gjimnazistët janë më të rëndësishmet që pjesa më e shkolluar e vendit i ka bërë me kohë vetes. Sikurse do ta shohim ca më poshtë, pa arritur në të vërtetë deri më tani të ngrejë shtylla, të sqarojë pyetje, të hapë udhë të reja.

Duke qenë se momentet demokratike që kemi përjetuar si popull e si shtet deri para 1990 kanë qenë fare të pakonsiderueshme, atëherë demokracia te ne në radhë të parë ka qenë dhe është e moskuptuar. Meqenëse ajo u konceptua vetëm e thjesht si antipodi i diktaturës, atëherë ajo nuk kishte se si të mos ishte **e moskuptuar**. Sidomos në fillim të viteve '90, por edhe sot e kësaj dite demokracia është parë si ilaçi që menjëherë, sakaq i zgjidh të gjitha problemet, sidomos ato të varfërisë. Demokracia te ne u konsiderua, dhe konsiderohet, si mjete që sjell lumturinë personale, të ndarë, në shumë raste krejtësisht nga mirëqënia shoqërore apo e grupit. Koncepti i lirisë ka parasysht një njeri të cilit i jepet e drejta tashmë të bëjë çdo gjë: Të zaptojë pronat e dikujt tjetër, mall e gjë, të sillet si të dojë – Jemi apo nuk jemi në demokraci? Rregulla shtrënguese kishte vetëm diktatura! – madje edhe t'i marrë jetën tjetrit me një lehtësi të pakonceptueshme. Demokracia e konceptuar kështu dhe liria personale si dhu-në ndaj tjetrit, që buron prej së parës, është një nga tiparet më thelbësore të demokracisë sonë.

Përveçse e moskuptuar, te ne demokracia është edhe **e keqkuptuar**. Duket sikur mjafton të bënim disa ligje, të shanim me domosdo sistemin që porsa kishim kaluar dhe pastaj të rrinim në pritje, njësoj sikur të kishim mbjellë një pemë nga ato që japin prodhim që në vitin e parë. Një lloj nxitimi, nganjëherë edhe i jus-



tifikuar, për të arritur në pak kohë atë çka popuj të tjerë kanë arritur në shumë shekuj, na ka shoqëruar përditë, në çdo orë e në çdo çast në këta 20 vjetët e fundit. Dhe një popull që i hedh hapat nxitimthi, pa u menduar e kuturu e ka shumë të kollajtë që të gabojë, të rrëzohet, të plagoset, dhe kështu edhe të zhgënjehet. Zhgënjimi hera-herës ka shkuar aq larg sa që shumë herë thuhet: Ah, ky vend nuk bëhet ndryshe veçse me një dorë të fortë! Pas kësaj mënyre të menduari pseudopatriotike janë fshehur shumë herë mënyra qeverisjeje që mbartnin mbi shpinë një dozë jo fort të vogël të mbeturinave diktatoriale të së shkuarës.

Sikur të mos mjaftonin këto dy të parat demokracia te ne është edhe **e keqpërdorur**. Demokracia, ajo e vërteta, është edhe triumfi i vlerave dhe meritave të njeriut të rritur në liri. Në vend të këtij personazhi, simbol të demokracisë, ne deri më tash kemi ngritur në piedestalin e pushtetit njerëz që nuk kanë asnjë vlerë shoqërore, profesionale, intelektuale. Të vetmet merita të tyre janë se kanë lidhje fisnore e krahinore me të fuqishmët e vendit dhe se janë militantët më të dalluar në tubimet e zhurmshme. Është krijuar kështu një *demimonde* politike, që përbëhet nga pasuesit servilë dhe interesaxhinj të pushtetit, të cilët kanë nisur të ngrënë një hendek si ato të kështjellave mesjetare midis tyre dhe shumicës së popullit.

Mbase nuk është nevoja të themi se kjo pjesa tribalo-militante është njëherazi edhe pjesa më pak e kulturuar e popullit dhe, sikurse dihet, demokracia dhe injoranca nuk para shkojnë fort mirë bashkë.

Termi demokraci te ne mbase mund të barazohet më mirë me termin postdiktaturë. Demokracia shqiptare i ngjan një adoleshenti që hera herës është i vrullshëm, i paparashikueshëm, kokëfortë, hatërmbetës, egoist, pa përvojë, por me dëshirën e madhe për të qenë dikushi. Dhe, sikurse ndodh ngaherë, vjen një ditë që edhe adoleshenti më klasik, befas e ndjen veten të rritur. Kjo ditë është duke ardhur edhe për demokracinë shqiptare.

*Fatos Baxhaku, publicist  
Tiranë, gusht 2013*

Si anëtare e jurisë u impresionova nga përqsja e të rinjve ndaj aktualitetit politik në vend. Të rinjtë janë të mirëinformuar lidhur me politikën. Ata janë të aftë ta perceptojnë demokracinë në mënyrën e tyre. Me sa duket, ata janë të ndërgjegjshëm lidhur me nevojën për ta ndryshuar atë perceptim që i sheh qytetarët “në opozitë”. Është krejt e kundërta: qytetarët janë në pushtet, llogaridhënia është rregulli i parë i një demokracie funksionale. Të gjithë pjesëmarrësve në garë: Mirënjohje për kontributin!

*Mimoza Koçiu*

E vlerësova së tepërmi mundësinë e pjesëmarrjes në këtë juri. Të shkruash një ese mbi demokracinë nuk është diçka e lehtë, pasi eseja është një zhanër letrar që ka si parakusht të menduarit filozofik. Më bënë përshtypje esetë e të rinjve, mendimi i tyre i mprehtë dhe i kultivuar. Më gëzon fakti që brezi i ri e kupton demokracinë në një nivel dhe mënyrë që mungonte në të shkuarën.

*Frrrok Çupi*

Në fillim të kësaj nisme, kisha si pritshmëri, ashtu dhe dyshime. Por këto të fundit u davaritën sapo nisa të udhëtoj nëpër Shqipëri, duke takuar të rinjtë e Pukës, të Korçës, Lezhës, dhe Kukësit. Ata ishin mëse të aftë të shprehnin qëndrimet e tyre lidhur me botën, si larg ashtu dhe afër tyre. Ata më bënë të mendoj se demokracia ka një të ardhme, si në qytetet e mëdha të Shqipërisë, me një traditë të konsoliduar angazhimi qytetar, ashtu dhe në qytetet e saj më të largët. Të rinjtë që takuam ishin mbresëlënëse. Ata ishin në gjendje të debatonin si qytetarë, të aftë të ndryshonin fatin e tyre dhe të kërkonin më shumë. Ky ishte gjithashtu mendimi i anëtarëve të jurisë, me të cilët pata nderin dhe kënaqësinë të bashkëpunoj. Falenderoj znj. Mimoza Koçiu, z. Frrrok Çupi dhe z. Fejzi Braushi për kontributin e tyre në juri, si dhe znj. Alma Puka, znj. Erendra Taipllari, z. Astrit Brasha dhe z. Rustem Strugaj për mbështetjen e tyre në terren. Gjej rastin t'i shpreh mirënjohjen znj. Rezarta Delisula, z. Gjergj Bojaxhi dhe z. Fatos Baxhaku të cilët ndanë me ne mendimet e tyre lidhur me demokracinë.

*Dr. Alenka Verbole*

